



2-180/8456
20.09.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/10/22
Datë: 20.09.2022 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e dhjetë - (2022) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 27.09.2022, ora 10⁰⁰.

gm

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
2. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim – ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjopa komunale për vitin 2023;
6. Bartja dhe rritja e të hyrave vetanake;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Drejtorisë për Kadaster dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve;
8. Të ndryshme;



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-08/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	29.07.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tetë (8) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.07.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti Kryetarin e Komunës z. Ruzhdi Shehun, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj. Leunora Shehu-DA, znj. Vjollca Qestaj-DBF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Zenun Shala-DUKM, z. Fatos Shala-DSHMS, z. Demokrat Ganiqaj-DSHPMS.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Lolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare, LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

Rendi i ditës i Propozuar:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Raportimi i kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Qershor 2022,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2021 dhe Plani i veprimeve për Zbatimin e rekomandimeve ,
4. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës së Junikut Janar-Qershor 2022,
5. Themelimi i Panellit Përzgjedhës të antarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara,
6. Të ndryshme.

z.Shpejtim Gacaferi, me kërkesë të Kryetarit të Komunës së Junikut, propozoi që pika e dytë e rendit të ditës të zhvendoset në pikën e gjashtë të rendit të ditës si dhe po ashtu kemi një kërkesë nga drejtori i drejtorisë së shëndetësisë që si pikë të rendit të ditës ta kemi, kërkesë për inicim të procedurave për plotësim ndryshimin e Statutit të QKMF_së," Dr. Ali Hoxha" Junik, rendin e ditës me këto propozime e qes në votim, për 15 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se me 15 vota për miratohet rendi i ditës me këto pika:

Rendi i Ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2021 dhe Plani i veprimeve për Zbatimin e rekomandimeve ,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës së Junikut Janar-Qeshor 2022,
4. Themelimi i Panellit Përzgjedhës të antarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara,
5. Kërkesë për inicim të procedurave për plotësim ndryshimin e Statutit të QKMF_së," Dr. Ali Hoxha" Junik,
6. Raportimi i kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Qershor 2022,
7. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,

z.Zenel Maloku, pershendetje për të gjithë, vërejtje të fjalimit im duhet të jetë kjo dhe jo si është e shkruar kja, vërejtje tjetër nuk kam.

z.Shpejtim Gacaferi, tjetër vërejtje nuk ka, e qes në votim procesverbalin me këto vërejtje që i dha z.Zenel Maloku, kush është për? Për 15 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së shtat u miratua me ato vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2021 dhe Planin e veprimeve për Zbatimin e rekomandimeve,

Arsyetimin dhe sqarimin e këtij raporti e bëri drejtoresha e Buxhetit e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe me pas fjalën ja dha zyratit të lartë për financa z.Arten Hamza që ta sqaroj dhe arsyetoi këtë raport me hollësiht para anëtarëve të Kuvendit.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, sa i përket raportit të auditimit kam një pyetje, rreth këtyre të gjeturave, a duhet dikush të jep përgjegjësi apo vetëm vazhdojmë të lejmë sit e gjetura.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, desha të nderlidhem me atë që e foli kryesuesi i grupit të kuvendit për LDK, ne jemi votuar për ndryshime dhe njerzit e pa përgjeshëm të cilët demtojnë komunën në aspektin ekonomik duhen të sjellen para organeve kompetente, për këtë kemi edhe një koalicion të lidhur mes LDK-LVV në Junik.

z.Leonard Lolluni, përshëndetje për të gjithë, unë kam vetëm një dëshirë nga ky ekzekutiv e ajo është që z.Arten Hamza, të rritet paga 1000€ pasi që është duke e kryer të gjithë punën e drejtorave këtu në Komunën e Junikut.

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës së Junikut Janar-Qeshor 2022,

Sqarimin dhe arsyetimin e këtij e bëri Kryetari i Komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, dhe me pas ja dha fjalën znj.Vjollca Qestaj që ajo ta sqaroj dhe arsyetoj para anëtarëve të kuvendit raportin financiar Janar-Qeshor 2022.

z.Lulzim Gacaferi, faleminderit drejtoreshë për këto sqarime, sa i përket këtij raportit financiar kam një pyetje që lidhet me shpenzimet e telefonit, që janë të shumta dhe unë them se këtu në Kosovë ka shumë operatorë të telefonisë që kanë oferta të lira, dhe pyetja është a e keni pa të udhës që të lidhni një kontratë me të lirë që të ulim këto shpenzime, dhe çështja tjetër është të subvencionet publike dhe jo publike, a kishit mundur të na bëni një sqarim me detaje.

Znj.Vjollca Qestaj, sa i përket shpenzimeve të telefonit, ju e dini se ne kemi gjetur një kontratë e cila është akoma valide por edhe kemi gjetur borxhe nga ekzekutivi i kaluar që ne është dashur që me buxhetin e viti 2022 të paguajmë borxhet e viti 2021 që janë mbi 1000000€, ndërsa sa i përket subvencioneve publike dhe jo publike ja kisha kaluar fjalën zyratit të lartë financiar z.Arten Hamza.

z.Arten Hamza, sa i përket kategorisë së subvencioneve, unë kisha mundur që për seancën tjetër ta sjelli një listë me detaje se ku janë përfituesit e këtyre mjeteve

z.Leonard Lolluni, të zyrat e kryetarit kemi shpenzim të telefonit në shumë 1190.50€, shërbime kontratuese tjera 338.50€ që nuk po dihet se çka janë, si dhe karburate për automjete 953.66€ që janë shumë për komunën e Junikut, të administratës shërbime tjera kontratuese 29146.09 të sqarohet se për çka është kjo, po ashtu edhe të Zhvillimi Ekonomik, shërbimet tjera kontraktuese 4912.94€ si dhe shërbimet publike 22076.69 shërbime tjera kontraktuese edhe kjo të na sqarohet

si dhe te shërbimet publike 4007.30€ karburant për automjete që mendoj se është shumë, këto janë sqarime që po ë kërkoj.

Znj.Leonora Shehu, përshëndetje për të gjithë, sa i përket administratës që ka shpenzuar 29146.09€ janë shpenzime të faturës dhjetor 2021 për "caritas", 12208€ në 7988€ është fatura e Tetorit 2021 si dhe 7880 është fatura e Shtatorit 2021.

z.Arten Hamza, në 105000€ janë obligime nga viti 2021 që janë bartë për këtë vit dhe në kemi në një listë që janë kemi prezentuar në raportet e më herëve siç janë raportet finaciat Janar-Mars 2022, të shërbimet tjera kontraktuese hynë edhe shërbimet e printimit, shërbimi i transportit të nxensëve.

z.Ruzhdi Shehu, raportet i përmban të gjitha shpenzimet e bëra në gjashtëmujorshin janar-Qeshor 2022, dhe në janë kemi prezentuar në raportin e parë janar-mars 2022 në detaje edhe raportin e borxhit të trashëguar, ku siç po shihet nuk e kemi lexuar fare, por edhe për kundër kësaj në do jua sjellim prap në seancën e radhës raportin në detaje. Cilat kategori kanë shpenzuar, aktivitetet që i kemi ndërmarr, të gjitha do t'i kenë në detaje në raportin e radhës finaciar.

z.Leonard Lolluni, këtu të shërbimet publike kemi të prezentura disa aktivitete që janë ndërmarr a si shpenzim nuk i kemi fare të prezentuara, po na i prezentoni vetë borxhet.

z.Ruzhdi Shehu, 70407€ janë obligime nga caritasi, të cilat është një kontratë e cila ka pasur afër 54 puntorë të angazhuar, derivate 10719€ për nxemjen, gjenerator dhe vetura obligime të pa paguara nga viti i kaluar, shërbime të printimit 1284€ borxhe të viti të kaluar, transporti i nxensëve 5764.80€ këto janë disa nga obligimet nga viti i kaluar, këto i kemi pasur edhe në raportin e parë, ndërsa sa i përket projekteve të realizuar për janar-qeshor 2022 janë mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit dimror pa shpenzim të buxhetit është angazhim i ynë vetanë, kemi bërë organizimin e stacionit të autobusëve, aktivitet i shërbimeve publike, është kryer projekti i sinjalizimit vertikal i shenjave sinjalizuese si dhe është bërë shërimi i kalimit të kambësorëve dhe i personave me aftësi të kufizuara edhe kjo është pa shpenzim, aktivitet i kryer me angazhimin e drejtorit të shërbimeve publike, këto janë disa aktivitete që janë bërë por janë bërë pa asnjë shpenzim.

4. Themelimi i Panellit Përzgjedhës të antarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara,

Sqrimin dhe arsyetimin e kësaj pike e bëri z.Shpejtim Gacaferi.

Propozimet për Panellin Përzgjedhës të antarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara: grupi i LDK_së propozon znj.Ermelinda Lolluni,
grupi i LAK_së propozon znj.Festina Maloku,
grupi i LVV_së propozon znj.Eliza Pepshi,
Ekzekutivi propozon znj.Venara Shala,
OJQ_të propozojnë znj.Savetë Shehu.

z.Shpejtim Gacaferi, e hudhim ne votim keto propozime, per 15 vota, kunder 0 vota, abstenim 0 vota konstatoi se propozimet per panelin perzgjedhes per antaret e komitetin konsultativ per persona me aftesi te kulizuara u miratua.

5. Kërkesë për inicim të procedurave për plotësim ndryshimin e Statutit të QKMF së: " Dr. Ali Hoxha" Junik,

Sqarimin dhe arsyetimin e kesaje pike e beri z.Shpejtim Gacaferi.

Sqarim dhe arsyetim shtese beri edhe Kryetari i Komunes z.Ruzhdi Shehu.

z.Leonard Llojuni, meqe nga kuvendi kerkohet vetem dy antarë ne si grupe heqim dore te perfaqsimi ne kete komision dhe ja lirojme vendin grupit te LVV.

z.Shpejtim Gacaferi, ateher po i presim propozimet:

LDK propozon zn.Lirjeta Shehu

LVV propozon znj.Eliza Pepshi

Ekzekutivi propozon z.Demë Ukaj dhe znj.Venera Shala

QKMF propozon z.Dr.Ali Kuçi.

z.Shpejtim Gacaferi,e qesim ne votim keto propozime, kush është për këtë përbërje? për 15 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota konstatoi se komisioni u miratua.

6. Raportimi i kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Qershor 2022,

Arsyetimi dhe sqarimin e këtij raporti e beri kryetari i Komune se Junikut z.Ruzhdi Shehu.

z.Leonard Llojuni,e pergezoi Kryetarin e Komunës per prezentimin e këtij raporti, sa i përket drejtorisë se zhvillimit ekonomik ku unë kam qenë drejtor e di se sa kam lenë borxhe, e borxhi qe kam lenë është 3790€, por me beri pershtypje se kan dal disa fatura te "Drinit te Bardhë", realisht mua me ka ardhur nje fature pak para perfundimit te mandatit si drejtor me ka ardhur dhe une nuk kam qen ne dijeni se kemi pasur kontrate me "drinin e bardhe" dhe atë faturë as qe e kam pranuar.

Znj.Gentiana Tofaj, pershendetje per te gjithë, sa i përket marrëveshjes me "Drini i Bardhë", marrveshja ka qenë per dy vite marrvesja eshte per vitin 2020 dhe 2021 dhe janë tri fatura, nje faturë eshte me protokol, ka qenë e pranuar nga ti ndërsa dy tjera kanë qenë pa protokol te pranuar nga zyrtari i zhvillimit ekonomik qe besoi ju ka përcjellë juve.

z.Leonard Llojuni, per deri sa nuk ka pasur konstatim per kryerjen e punëve se çfarë ka kryer ky operator une nuk i kam pranuar këto fatura.

Znj.Gentiana Tofaj, po si do qe te jetë këto fatura tani nuk varen nga ne, ato janë te përimbaruesi. z.Leonard Llojuni, permbaruesi nuk mundet ti terhek mjetet sepse nuk ka raport qe ky operator ka kryer punë ne Komunën e Junikut dhe une nuk kam patur kontratë te lidhur me këtë operator "Drini i Bardhë".

z.Arten Hamza, komuna e Junikut ka kontrate me operatorin "Drini i Bardhë" mirëpo kontrata ka devijuar dhe ne në bordin e Drejtorëve të ekzekutivit të kaluar i kemi diskutuar këto dy fatura, për këtë je ne dijeni edhe ti.

z.Leonard Llojuni, unë zyrtarisht nuk jam në dijeni për këto dy fatura, vetëm privatisht, dhe për Drejtorinë ku unë e kam drejtuar, unë e di saktë sa kam lenë obligime.

7. Të ndryshme,

z.Zenel Maloku, unë kam disa çështje për ti ngritur këtu para jush, e para është rruga Junik-Gjocaj, aty ku ka rreshitur dheu, kanë vendosur disa gurë, sipas mendimit tim kjo është një gabim dhe mendoj se komuna duhet të ndërtoj sepse vendosja e këtyre gurëve paraqet rrezik për të ardhmen, e dyta është të rruga që gjendet afër familjes që banon në Gjocaj, aty janë disa gurë që janë potencial të rreshqasin dhe të rrezikojnë këtë familje, kjo familje ka edhe fëmijë, unë ju kisha drejtuar Drejtorit të shërbimeve Publike, kryetarit të Komunës, të ndermeren masa të vendoset një muri mbrojtës para se të ndodhë diçka që ne me u penduar, e treta çështje është një kërkesë e qytetarëve që jetojnë në atë pjesë, që kryetari i komunës të përpiqet ta bëjë rrugën aty ku është dhe ta lidhë me rrugën e bjeshtë, sepse nuk është rrugë që do aq punë shumë, çështja e katër është për lapidarian që ndodhet në Xhaminë në qendër, këtë çështje e kemi biseduar edhe me heret dhe unë mendoj që ky lapidar të hiqet pasi që të njëjtit emra që janë të vendosur të lapidari i heroit "Edmond Hoxha", çështja e pestë është shqetsimi i qytetarëve të qendrës që pretendojnë që komuna ju ka marrë tokë, ka edhe organizatë që thotë na ka marrë komuna tokë, andaj kërkoj nga Drejtoria e Kadastrit që të na bje gjendjen e fletave poseduese për qendër që të dimë se kujt ju ka marrë toka.

z.Ruzhdi Shehu, sa përket rrugës Junik-Jasiq-Gjocaj, është projekt i më hershëm dhe akoma nuk është në përfundim, ne kemi një komision komunal që bën monitorimin e punëve, po ashtu ka edhe një komision nga ministria që monitoron punët për këtë rrugë, këto komisione janë duke u munduar që si është me se miri të shkojnë punët, sepse është teritor jo i përshtatshëm për ndërtimin e rrugëve sidomos në vendin mbi Gjocaj, ndërsa sa i përket rrugës për të familja e Nezir Gjocaj, e kemi parë atë gjendje, ne nuk kemi gjetë projekt për këtë rrugë dhe po ashtu nuk kemi mjete të alukuar për këtë çështje, mirë se e ngritje si çështje dhe në kur të vijë koha e planifikimeve për projekte do të shikojmë mundësinë që të ndërtojmë në këtë pjesë në vitin e ardhshëm, tani për tani nuk mundemi të ndërtojmë sepse çdo gjë është e planifikuar për këtë vit, sa i përket lapidarit e kemi patur edhe një herë me heret këtë çështje, pllaka që gjendet në Heroi Edmond Hoxha duhet të përshohet sepse ka disa emra dhe data që janë gabimisht, do të shikojmë mundësinë që të korigjojme të gjitha gabimet dhe do të bisedojmë me të gjithë akteret si Bashkësi islame dhe të tjerët dhe të kemi një projekt për qendër, sa i përket uzupimeve në qendër unë kam një listë e kemi patur edhe në kuvend dhe këtë listë e kam gjetur të gatshme, dhe ka proceduar që janë edhe në gjykatë dhe këto çështje nuk zgjidhen me shkop magjik, unë jam që tani e tutje të mos ndodhin uzupime.

z.Leonard Llojuni, kryesues sipas rregulloreve të punës së kuvendit, kryesuesi i grupeve parlamentare e marrin fjalën si të parët andaj respekto këto rregullore të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, unë e di këtë dhe ashtu është edhe me rregullore, por asnjëri nga tre kryesuesit e grupeve nuk e kërkuat fjalën andaj ja dhashe fjalën z.Zenel Maloku.

z.Dervish Bajraktari, pershendetje për të gjithë, unë i kam dy çështje, e para është kanalizimi i ujërave të zeza që është në "lagjen Bajraktarë" është i bllokuar dhe era kundërmon shumë, dhe çështja tjetër është rruga po në këtë lagje që lidhë Bajraktarë - "Krasniq" dhe "Shalaj" e deri në "lagjen Gaxherr", është shumë e demtuar dhe një automjet sa do që të është e ka shumë të vështirë të kalojë prej gropave dhe therrave që e kanë ngushtuar këtë rrugë, a keni ndërmend të ndermëni diçka për këtë çështje si psh, ktu në qendër keni zhbllokuar një kanalizim të ujërave të zeza apo lagjeja Bajraktar nuk është prioritet për ju si ekzekutiv.

z.Ruzhdi Shehu, ka të drejtë z. Dervish Bajraktari për atë që si është gjendja në "lagjen Bajraktar", në jemi duke menduar se si të gjejmë zgjidhje që me zhblloku atë kanalizim të ujërave të zeza, po të ishte në listën e projekteve nga viti i kaluar në sot do e kishim të kryer, për ta kryer kërkohet një kosto e lartë, sepse kërkohet intervenim në kanalizim dhe asafalltim dhe një herë për një herë nuk mundemi të intervenojmë sepse nuk kemi mjete, për vitin e ardhshëm është një ndër projektet e para të intervenohet.

z.Leonard Llojuni, Kryetari me siguri është në dijeni se një organizatë serioze Zvicrane HELMETAS e ka qitur që besimi i qytetarëve të Komunës së Junikut ndaj Kryetarit Ruzhdi Shehu është në 40%, dhe çështja tjetër është një lajm në Facebook, që komuna e Junikut është anëtarësuar në "Strong Cities", dhe unë kam hulumtuar dhe ajo organizatë është e themeluar që tri ditë dhe po ashtu atë ditë që ka postuar në facebook komuna e Junikut atë ditë edhe është hapur faqja e Strong Cities, kjo që du atë them është se sa është serioze një lajm nga komuna. Si çështje tjetër është premtimi i kryetarit z. Ruzhdi Shehu gjatë fushatës zgjedhore që QKMF-ne do ta bëjë të funksionoj 24 orë.

Znj.Festina Maloku, pershendetje për të gjithë, unë kam një kërkesë që Komuna në lagjen "Miroc" e "Malok" të vendos policë të vdekur, pasi që shoferët e automjeteve po ngasin me shpejtësi të lartë dhe po paraqesin rrezik për këmbësorët andej.

z.Lulzim Gacaferi, z. Kryesues ashtu siq tha kolegu Leonard ta keni parasysh rregulloren e Kuvendit që të na epet fjalë në si kryesues të Grupeve parlamentare dhe jo ta shikoni vetëm një grupë të ipet fjalë vetëm atyre, në këtë rast vetëm AAK-se, nuk du atë jau cenoi fjalën askujt por të rrespektohet rregullorja e punës së Kuvendit. Qështja tjetër është, në mandatin e kaluar ky kuvend e ka miratuar një rregullore për orarin në grasonomi e që kemi parapare një ditë pushim, unë kërkojë që kjo rregullore të zbatohet serisht pasi që në këtë mënyrë në i mbrojmë puntoret në këtë sektor, qështja tjetër është po ajo që u ngrit nga z.leonard Llojuni që QKMF-ja të jetë funksionale 24 orë, në ju kemi premtuar qytetarëve të Komunës së Junikut se do ta funksionojmë QKMF-ne për orar të punës 24h dhe mendoj se kryetari i Komunës është duke punuar në këtë drejtim, dhe qështje tjetër është aparatura e rengelit që e kemi si donacion të mos largohet nga QKMF-ja por të shiqohet mundësia të funksionoj dhe të mbetet në QKMF dhe në funksion të pacientave dhe qytetarëve të Junikut, qështja tjetër është uji i pijes për lagjen "Agim Ramadani" në dije se projekti është ndaluar por unë mendojë se në e kemi dhënë një premtim gjatë fushatës zgjedhore dhe se mendoj që këtë premtim duhet ta qojmë deri në fund dhe lagja "Agim Ramadani" të lidhet me ujin e pijes, çështje tjetër ka të bëjë me kërkesën e Bajram Gacaferi i cili

kërkon që në kallavaj disa prona të banoreve të lagjes "Gacafer" të lidhen me kanalin e ujitjes, dhe qeshtja tjetër është në shtratin e lumit erënik në lagjen Gacafer afër shtëpive të familjeve Tofaj janë bërë disa gropa nga operatorët që kanë nxjerrur zhavor aty dhe ato gropat janë mbetur ashtu, kërkoj nga drejtoria e shërbimeve që të intervenojnë në këto gropat pasi që ato paraqesin potencial për rrezik për fëmijët tanë që tani e frekuntojnë këto hapsira për freskim nga vapa.

z. Ruzhdi Shehu, sa i përket ujit të pijes në lagjen "Agim Ramadani" është nisur projekti pa disponimin e mjeteve finaciare, që është shkëlqej ligjor, 53000€ na i ka marrë përmbaruesi, kështu që kemi edhe në raport të auditimit të cekur, sa i përket zgjedhjes në jemi shumë të interesuar që lagjeja "Agim Ramadani" të ketë ujë të pijes, sa i përket QKMF-së në kemi premtuar që të jetë funksionale 24h, por problemi është stafi mjekësor që po ikë nga Kosova, me këto politikat duhet që të merret shteti të bëjë zgjedhje që stafi mjekësor të mos ikë nga Kosova, por përkundrazi kësaj na do të tentojmë që QKMF-ja të startojë të funksionojë 24h, sa i përket aparatit të rëntigenit edhe në bazë të rregulloreve dhe funksionimit të QKMF-se do të shijojmë mundësitë që të funksionojë edhe kjo aparaturë sipas normave të QLMF-se, sa i përket kanaleve të ujitjes kemi të ndara 250000€ dhe siçsist prioritetet na do të ndertojmë këto kanale dhe besoj se edhe "Kallavaj" dhe të gjithë do të kyqen në kanale të ujitjes, është projekt që në aka mbështetë ministria e bujqësisë, sa i përket orarit për grasonomet, unë do të shikoj rregulloren e kuvendit, dhe do të ulemi me përfaqësuesit e bizneseve që të shijojmë të bëjmë me të mirën sepse Juniku është një zonë e ngushtuar dhe pak punë po kanë bizneset dhe tash është sezoni i verës ku ata presin që të kenë me shumë punë, mirëpo pajtona me atë që nuk bëjnë më e shfrytëzuar puntorin.

z. Shpejtim Gacaferi, e konstatoi të mbyllur mbledhjen e Korrikut
mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:35

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



DATE/A:	15.09.2022
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	
NGA/OD/FROM	Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis. <i>Zenun Shala</i>
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Kërkesë

Kërkoj nga Kuvendi Komunal i Junikut që të miratohet kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm Kadaster dhe Mjedis për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut nr. 02/04 të datës 05.03.2019 është miratuar emërtimi i Zonave të Qarkullimit Publik në Komunën e Junikut sipas propozimit të Komisionit Komunal për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik.

Sipas Ligjit për Sistemin e Adresave (Ligji Nr. 04/L-071, GZRK numër 29/2011) neni 9, nuk lejohet emra në gjuhë të huaj siq është emri Richard Holbruk i cili duhet të shkruhet shqip Riçard Holbruk. Kështu lejohet Parashtesa "Rruga" në emërtim të ndonjë rruge siq është p.sh. "Rruga e Gështenjave" të cilës duhet ti hiqet Parashtesa "Rruga" dhe të mbetet vetëm "E Gështenjave".

Pas shqyrtimit të emrave Agjensioni Kadastral i Kosovës ka vërejtur këto gabime teknike të cilat ka kërkuar të përmirësohen dhe ato përmirësimë të aprovohen nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Agjensioni Kadastral i Kosovës ka kërkuar që përmirësimet teknike të bëhen në këto rrugë:

Kodi i rrugës	Emrat e miratuar në kuvend	Emrat e përmirësuar
3	Rruga e UÇK-së	E UÇK-së
4	Rruga e Gështenjave	E Gështenjave
8	Richard Holbruk	Riçard Holbruk
9	Rruga e Kullave	E Kullave

2-155/8281

15 09 2022



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	09.09.2022
PËR/ZATO:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës <i>[Signature]</i>
NGA/OD/FROM:	Znj. Gentiana Tofaj - Drejtoreshë për Ekonomi dhe Zhvillim <i>[Signature]</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023.

Të nderuar,

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje lokale 03/L-040, neni 12, ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neni 8, dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, kërkojmë që të nxirret vendimi për lejimin e fillimit të procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023.

Arsyetim:

Plotësim- ndryshimi i rregullorës për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, siç rregullohet me ligjet në fuqi duhet të kalojë çdo vit në kuvendin komunal për rishqyrtim.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



2-155/3234
13.09.2022

DATE/A:	13.09.2022
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022, Sipas këtyre programeve

E hyra vetanake për vitin 2022 sipas planifikimit dhe realizimit

Tabela e planit dhe realizimit:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi Janar – Gusht 2022	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	11,481.00	8,854.86	(2,626.14)
2	Te hyrat nga urbanizmi	19,100.00	12.00	(19,088.00)
3	Te hyrat nga administrata	7,100.00	4,672.50	(2,427.50)
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,000.00	5,487.66	(4,512.34)
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	92,557.00	78,493.42	(14,063.58)
6	Regjistrimi i Automjeteve	6,000.00	5,538.50	(461.50)
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,200.00	4,478.50	(1,721.50)
8	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,100.00	1,295.00	(2,805.00)
9	Të hyrat tjera	2,500.00	191,924.75	189,424.75
	TOTALI	159,038.00	300,757.19	141,719.19

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Gusht 2022 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **300,757.19€**. Shuma e planifikuar për vitin 2022 është **159,038.00€**, ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar – Gusht 2022 në vlerë prej **141,719.19€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjybat në trafik në shumë prej **2,622.50€**.

Në mënyrë që të mundemi të alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **141,719.19€**, totali i të hyrave për vitin 2022 të rritet nga **159,038.00€** në **300,757.19€**.

Kjo rritje në vlerë prej **141,719.19€**, të bartet si në vijim :

- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit 46030 – 80,000.00€.
- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Ndërtimi i kanaleve të ujitjes me kod të projektit 47283 – 2,000.00€.

- Nën programi 66405 Planifikimi urbanizmi në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin "Asfaltimi i rrugëve lokale" me kod të projektit 45605 – 8,000.00€.
- Nën programi 93570 Arsimi fillor – Junik përkatësisht 93571 Shkolla fillore "Edmond Hoxha" Junik, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 10,000.00€.
- Nën programi 18020 Shërbime Publike Infrastruktura - rrugore, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 10,000.00€.
- Nën programi 66405 Planifikimi urbanizmi, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 31,719.19€.

Ju faleminderojmë për mirëkuptim!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



2-155/832
2
3
13.09.2022

DATE/A:	13.09.2022
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi- Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës 
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj, Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite Miratimin e Normave Tatimore për vitin 2023

Të nderuar,

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, përaktësisht Zyra e Tatimit në Pronë kërkon nga ju miratimin e Normave Tatimore për vitin 2023.

Të bashkangjitur në këtë kërkesë kenë dhe Raportin e Grupit Punues për caktimin e Normave Tatimore për vitin 2023.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



2-155-7982
2
08.09.2022

Data:	08.09.2022
Për/Za/To:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal
Nga/Od/From:	Grupi punues për plotësimin ndryshimin e Normave Tatimore për vitin 2023.
Përmes/Preko/Through:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës zj.Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
Tema/Subjekat/Subject:	Raport- Ndryshim Plotësimi i Normave të Tatimit në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.

Grupi punues i formuar nga Kryetari i Komunës me Vendim nr.01/68 dt:06.07.2022, për ndryshimin e Normave Tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, mbajti disa takime ku u diskutua për ndryshimin e normave tatimore për vitin 2023.

Në si grup punues bazuar në Ligjit mbi Tatimin në Pronë Nr.06/L-005 Neni 18. Pika 1-thotë se Ministria e Financave nëpërmjet Departamentit përkatës për tatimin në pronën e paluajtshme, kryen vlerësimin të përgjithshëm një herë në ç'do tre (3) deri në pesë (5) vjet.

Ndërsa Neni 9. i këtij ligjit parasheh se Kuvendi Komunal i ç'do Komune i cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, në përjashtim të kategorisë pronë publike, deri me 30 Nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit në përputhje me këtë Ligj.

Kuvendi Komunal duhet të rishikoj dhe të vendosë norma të reja vetëm nëse një gjë e tillë e kërkojnë rrethanat.

Ndryshimi i normave tatimore për herë të fundit është bërë në vitin 2020, për të gjitha kategoritë e pronave në normën minimale 0.15%, me vendim të Asamblesë Komunale për shkakë të situatës me Pandemi Covid-19, ky vendim është përcjellë gjatë viti 2021-2022.

Mirëpo këtë vit Departamenti i Tatimit në Pronë ka filluar një vlerësim të ri për njësitë e objekteve dhe parcelave rezidenciale, gjatë këtij procesi të vlerësim pritet të jetë bashkëpunimi sa më i mirë ndërmjet Zyres së Tatimit në Pronë me Departamentin e Tatimit në Pronë.

Në takimin e fundit të mbajtur me datë: 07.09.2022, ne si grup punues në bashkëpunime edhe me akterët e tjerë Komunal:

R e k o m a n d o j m ë: Normat tatimore për vitin 2023, përfshirë të gjitha njësitë e objekteve edhe parcelave të mbesin të njëjta, përdërisa vazhdon të jetë një gjendje e njëjtë krahasuar me dy vitet e fundit me Pandemi Covid-19, ku njëherë jemi duke u ballafaquar edhe me rritjen e inflacionit që ç'është ditë e ma shumë ka prekur ekonomitë tona familjare.

Shtesë : Tabela e normave aktuale për tatimin në pronë:

KATEGORIA E PRONËS	Normat tatimore
Për njësitë bujqësore parcelave	0.15%
Për njësitë bujqësore objektve	0.15%
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
Për njësitë komerciale të parcelave	0.15%
Për njësitë komerciale të objekteve	0.15%
Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
Për njësitë industriale të objekteve	0.15%

Saranda Isufaj -Kryesuese



Arten Hamza -Anëtar



Florant Pepshi-Anëtar



data: 08.09.2022



2- 15/8433
25
13.09.2022



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	13.09.2022
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	Znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvendin komunal shqyrtimin dhe miratimin e Buxhetit për vitin 2023/2025

I nderuar,

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (L.MFPP) nr. 03/L-048, neni 20, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 24 dhe ligji për Financat e Pushteti Lokal nr. 03/L-049, neni 23,24 dhe 25 dhe në bazë të limiteve nga Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve në përputhje me qarkoren e dytë buxhetore 2023/02, kërkojmë që të shqyrtohet dhe të miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2023/2025.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

(Projekt)

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
KOMUNALE**

2023- 2025

JUNIK, 2022

I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-it 2023-2025 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2023/01 për Komunitat, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Cagjet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe cagjeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2023-2025.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Junikut është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e cila është ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2023/2025 të dhëna nga MFPT përmes qarkores buxhetore 2023/01 .

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Junikut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2023 – 2025, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
4. Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

II. OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Me kornizën afatmesme buxhetore 2023–2025 të Komunës së Junikut synohen të arrihen këto objektiva:

- ❖ Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- ❖ Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- ❖ Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- ❖ Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- ❖ Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- ❖ Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talentëve etj.

III. Perspektiva e politikave fiskale

Korniza makroekonomike

Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2025 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat dhe Gjokat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra, siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Tabela 2. Vlerësimet e hershme të buxhetit 2023

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Viti buxhetor (2022)					Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2023)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2024)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2025)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	78.7	6.7	0.2	50		78.0	7.7	0.2	52		76.4	7.7	0.2	52		76.7	7.7	0.2	52	
K. Komunal	60.2	4.0				59.4	4.0				59.4	4.0				59.5	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kartaster	48.7	9.9			70	49.5	17.8			115	49.7	17.8			164	49.9	17.8			200
D. per Administratë te përgjithshme	85.7	49.3	6.7			85.7	47.1	7.2		30	86.1	47.1	7.2			86.4	47.1	7.2		
D. Buxhet dhe Financave	64.6	7.0	0.1			64.1	7.9	0.1			64.4	7.9	0.1			64.7	7.9	0.1		
D. Ekon. Bujqesi, pylltar dhe turizem	53.3	10.1	0.4		65	52.9	10.0	0.4		110	53.1	10.0	0.4		150	53.4	10.0	0.4		169
D. Shërbimeve Publike	55.9	36.5	13.3		70	53.9	33.8	13.6		110	54.1	38.8	14.7		150	54.4	41.8	15.0		179
D. e Arsimi	35.6	4.7				35.5	4.5				35.8	4.5				35.8	4.5			
D. e Shëndetësi	15.5	4.2				17.5	2.9				17.6	2.9				17.7	2.9			
ZKX	6.7					6.9					6.9					7.0				
TOTALI:	504.8	132.3	20.6	50	205	501.5	135.7	21.4	52	385	503.42	141	22.5	52	464	505.37	144	22.8	52	539
Arsimi filor	289.4	32.2	4.9		10	299.7	30.5	5.0		20	300.9	32.5	5.0		20	302.1	33.5	5.0		20
Arsimi i mesëm	125.5	10.7	3.6			124.2	16.1	3.6			124.7	16.1	3.6			125.1	16.1	3.6		
OKMF	224.4	24.1	5.7			234.2	37.6	5.7		10	235.2	37.6	5.7		10	236.1	37.6	5.7		10
Mirëqenia Sociale	10.5	3.5	1.4			11.4	1.8	2.0			11.5	1.8	2.0			11.5	1.8	2.0		
SUB TOTALI	1154.6	202.8	36.2	50	215	1171	221.7	37.7	52	395	1175.6	229	38.8	52	494	1180.3	233	39.1	52	569

SPECIFIKACION

BUXHETI KOMUNAL JUNIK	VITI 2022 (000 EURO)	VITI 2023 (000 EURO)	VITI 2024 (000 EURO)	VITI 2025 (000 EURO)
	1,659	1,877	1,989	2,073

iv. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2022.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend rritës për vitin 2023 gjithashtu edhe për dy vitet tjera pasuese me një trend të rritjes për çdo vjet.

Grandet qeveritare kanë rritje për vitin 2023 gjithashtu me një trend të rritjes në vitet pasuese të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MFPT.

Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal

Më datën 13.05.2022 kanë arritur limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2023/2025. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Junikut është si vijon:

Tabela nr. 3 Limitet fillestare sipas qarkores buxhetore 2023/01

Limiti fillestar	Granti i Arsimit	Granti i Shëndetësisë	Granti i Përgjithshëm	Gjithsej granti Komunal
2023-Kufijtë e financimit	462,526	253,367	1,002,123	1,718,016
2024-Parashikimet	492,475	266,035	1,065,520	1,824,030
2025-Parashikimet	494,684	279,337	1,127,536	1,901,557

Tabela nr.4. Projekcioni i të hyrave Buxhetore nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake 2023/2025 të Komunës së Junikut

K. K. Junik	Buxheti - 2023	Buxheti - 2024	Buxheti - 2025
Të hyrat nga granti qeveritar	1,718,016	1,824,030	1,901,557
Të hyrat vetanake	159,330	165,151	171,584
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073,141

Tabela nr. 5. Korniza afatmesme buxhetore 2023/2025 sipas kufijve fillestar

K. K. Junik	Buxheti - 2023	Buxheti - 2024	Buxheti - 2025
Paga dhe mëditje	1,170,906	1,175,602	1,180,271
Mallra dhe shërbime	221,740	228,740	232,740
Shpenzime komunale	37,700	38,839	39,130
Subvencione	52,000	52,000	52,000
Investime kapitale	395,000	494,000	569,000
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073,141
Burimet e financimit			
Granti i Qeverisë	1,718,016	1,824,030	1,901,557
Të hyrat vetanake	159,330	165,151	171,584
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073,141

Më datën 15.08.2022 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2023/02 për Komuna në të cilën janë të specifikuar struktura e shpenzimeve sipas Kategorive ekonomike për vitin 2023 dhe parashikimet për 2024-2025. Sipas kësaj Qarkoreje Buxhetore Buxheti total i Komunës së Junikut është i njëjtë me qarkoren e parë në shumë prej 1,877,346.00€. Struktura e shpenzimeve për Komunën e Junikut sipas Qarkores 2023/02 është:

- Paga dhe mëditje	1,170,906.00
- Mallra dhe Shërbime	236,740.00
- Shpenzime Komunale	37,700.00
- Subvencione dhe transfere	52,000.00
- Shpenzime Kapitale	380,000.00
Totali	1,877,346.00

Tabela nr. 6. Korniza afatmesme buxhetore 2023/2025 sipas Qarkores 2023/02

K. K. Junik	Buxheti - 2023	Buxheti - 2024	Buxheti - 2025
Paga dhe mëditje	1,170,906	1,176,761	1,182,644
Mallra dhe shërbime	236,740	236,740	240,000
Shpenzime komunale	37,700	38,839	39,130
Subvencione	52,000	52,000	52,000
Investime kapitale	380,000	484,841	559,368
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073,142
Burimet e financimit			
Granti i Qeverisë	1,718,016	1,824,030	1,901,557
Të hyrat vetanake	159,330	165,151	171,584
TOTALI	1,877,346	1,989,181	2,073,141

Në tabelën vijuese pas pranimit të limiteve finale do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit final sipas programeve për vitet 2023/2025

Tabela nr. 7. Shpërndarja e shpenzimeve buxhetore për periudhën 2023/2025 pas qarkores së dytë

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2023)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2024)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2025)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	76.3	7.7	0.2	52		76.6	7.7	0.2	52		77.0	7.7	0.2	52	
K. Komunal	59.4	4.0				59.4	4.0				59.5	4.0			
D. për planifikim urban, Gjeodezi dhe kadastro	49.5	17.8			190	49.7	17.8			250	49.9	17.8			95
D. për Administratë të përgjithshme	85.7	47.1	7.2		35	86.1	47.1	7.2			86.4	47.1	7.2		
D. Buxhet dhe Financave	63.9	7.9	0.1			64.1	7.9	0.1			64.4	7.9	0.1		
D. Ekon. Bujësi, pylltari dhe turizmi	52.8	10.0	0.4		80	53.1	10.0	0.4		154.84	53.4	10.0	0.4		139.37
D. Shërbimeve Publike	53.9	38.8	13.6		55	54.1	38.8	14.7		50	54.4	41.8	15.0		50
D. e Arsimit	35.5	4.5				35.6	4.5				35.8	4.5			
D. e Shëndetësisë	17.5	2.9				17.6	2.9				17.7	2.9			
ZKK	6.9					6.9					7.0				
TOTALI:	501.39	140.7	21.4	52	360	503.416	140.7	22.539	52	454.84	505.37	143.7	22.83	52	284.37
Arsimi fillor	301.8	39.5	5.0		10	304.1	39.5	5.0		20	306.5	39.5	5.0		20
Arsimi i mesëm	122.2	17.1	3.6			122.7	17.1	3.6			123.1	17.1	3.6		
QKMF	234.2	37.6	5.7		10	235.2	37.6	5.7		10	236.1	37.6	5.7		255
Mirëqenia Sociale	11.4	1.8	2.0			11.5	1.8	2.0			11.5	1.8	2.0		
SUB TOTALI	1170.9	236.74	37.7	52	380	1176.8	236.74	38.839	52	484.84	1182.6	239.74	39.13	52	559
SPECIFIKACION															
BUXHETI KOMUNAL JUNIK	VITI 2023 (000 EURO)					VITI 2024 (000 EURO)					VITI 2025 (000 EURO)				
	1,877					1,989					2,073				

Strategjia e shpenzimeve sipas Drejtorive/Programeve dhe deklarata e misionit dhe qëllimeve

ZYRA E KRYETARIT

Kryetari: Ruzhdi Shehu

Deklarata e misionit: Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij; ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon zëvendësit dhe drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative të investuese, propozon Buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerri aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.

Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve etj. Gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë etj. Ofron çasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e Komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

Kategoritë buxhetore	2023	2024	2025
1 Paga dhe mëditje	76,281.73	76,632.08	76,982.45
2 Mallra dhe shërbime	7,700.00	7,700.00	7,700.00
3 Komunalit	150.00	150.00	150.00
5 Subvencione	52,000.00	52,000.00	52,000.00
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	136,131.73	136,482.08	136,832.45
Numri i të Punësuarve	8	8	8

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL**Kryesuesi: Shpejtim Gacaferi**

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i Komunës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Kuvendi i Komunës mund të miratoi aktet dhe të ndërmerr masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejnë brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e Komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

Deklarata e qëllimit: Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e për kujdesit publik shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale; turizmin, aktivitet kulturor dhe të lira, çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk është përcaktuar ndonjë autoritet tjetër.

Kategoritë buxhetore		2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	59,375.67	59,416.21	59,456.75
2	Mallra dhe shërbime	4,000.00	4,000.00	4,000.00
3	Komunalit	-	-	-
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		63,375.67	63,416.21	63,456.75
Numri i te Punësuarve		15	15	15

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**Drejtori: Leonora Shchu**

Deklarata e Vizionit: Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që u përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre.

Deklarata e Misionit: Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative – teknike të drejtorisë dhe ato të Shërbimit Civil Komunal që bien në këtë kompetencë. Udhëheqë me librat amë, të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjellë aktvendime për regjistrime të mëvonshme, përmirësime dhe ndryshime të emrit e mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, zyrën e pritjes, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, logjistikës, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit me vendbanimet dhe fshatrat. Gjithashtu kryen edhe punë të tjera që janë kompetencë e drejtorisë e që janë të bazuara në ligje, statut të Komunës, rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat janë në fuqi.

